

Shpjegimet e mëposhtme duhet t'ju ndihmojnë juve, t'i kuptoni detyrat dhe mundësitë e punës socialpedagogjike për familjen.

[Çfarë është puna për familjen](#)

Për shkaqe të ndryshme një familje mund të ketë nevojë për mbështetje në formë të punës për familjen. Punonjësi social përkatës/punonjësja sociale përkatëse, me pëlqimin tuaj, do ta regjistrojë familjen tuaj tek "Rötel". Një pedagog social ose një pedagoge sociale do t'ju vizitojë pra juve në shtëpi për një kohë të caktuar dhe do të punojë me ju në tema të ndryshme të jetës së përditshme dhe /ose të edukimit. Në fillim ju takoheni me punonjësen për familjen/punonjësën për familjen dy deri tre herë në javë, më vonë, sipas ecurisë, gjithmonë e më pak. Një vizitë zgjat rreth tre orë. Terminet planifikohen [së bashku] me ju. Një shërbim socialpedagogjik për familjen zgjat disa javë, maksimumi deri në një vit.

Pedagogja sociale/pedagogu social duhet t'i njohë anëtarët e familjes. Është e nevojshme, që të gjithë të marrin kohë për bisedat. Kështu njeh punonjësja për familjen/punonjësi për familjen jetën tuaj të përditshme me qëllim që të kërkojë së bashku me ju për mundësi përmirësimi. Sipas nevojës, vetëm me lejen tuaj, pedagogja sociale/pedagogu social lidh kontakte me persona të tjerë, si mësues, terapeutë etj.

Punonjësja për familjen/punonjësi për familjen punon pjesërisht me gjithë familjen, nganjëherë po ashtu vetëm me anëtarë të veçantë të familjes, kjo planifikohet me ju. Bashkërisht përpunohen rregulla dhe ecuri, ushtrohen strategji të reja dhe/ose sipas mbështetjes që nevojitet, kërkohen ato edhe jashtë familjes.

[Synimi i një shërbimi socialpedagogjik për familjen](#)

Në qendër ndodhet synimi, që ju të mundni të përballoni jetën tuaj të përditshme dhe/ose detyrat e edukimit pa ndihmë të huaj sa më shpejt që të jetë e mundur. Temat që do të trajtohen në shërbimin për familjen do të përcaktohen së bashku në një bisedë të parë të përbashkët dhe gjatë ecurisë do të formulohen synime konkrete. Çdo tre muaj, në një bisedë të përbashkët, në të cilën merrni pjesë ju, caktuesit [e shërbimit] dhe punonjësja për familjen/punonjësi për familjen, rishqyrtohet nëse shërbimi është i suksesshëm dhe se si do të duken hapat e mëtejshëm.

[Dokumente me shkrim](#)

Punonjësja për familjen/punonjësi për familjen shkruan një protokoll nga biseda e parë dhe nga bisedat e vendndodhjes. Nga biseda e parë e vendndodhjes do të përgatitet një raport paraprak, në të cilin do të përmbahen situata aktuale dhe synimet për kohën e ardhshme. Në përfundim të shërbimit do të përshkruhen në një raport përfundimtar ecuria dhe rezultatet e punës së përbashkët. Raportet dhe protokollet do t'ju tregohen juve, para se ato t'i çohen caktuesit [të shërbimit].

[Kostot](#)

Kostot për shërbimet për familjen paguhen nga komunat përkatëse. Këto, si pasojë e situatës suaj financiare, llogaritin një kuotë për prindërit dhe ua vendosin juve këtë në faturë.

Shërbime të caktuar, të cilat ju nuk mund t'i zbatoni, duhet t'i anuloni më së voni 24 orë përpara tek punonjësja për familjen/punonjësi për familjen, në rast tjetër kostot duhet të vendosen në faturë.

[Detyrim heshtjeje](#)

Të gjithë punonjësit e "Rötel" qëndrojnë nën detyrim heshtjeje. Ata nuk lejohet të flasin për ju me fqinjët, bashkatdhetarët ose me të njohurit. Caktuesit [e shërbimit] informohen mbi ecurinë dhe rezultatet. Në rast të bisedave me persona të tjerë të specializuar ju merrni pjesë në to ose ju na keni lejuar ne, që të marrim kontakt me ta.